



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PERKOHSHME VETEQEVERISESE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVES – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCES DHE TEKNOLOGJISE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

UDHËZIM ADMINISTRATIV

LËNDA: KATEGORITË E STUDENTËVE PËR ASISTENCË SI DHE KUSHTET PËR FITIMIN E ASISTENCËS

NUMËR : MASHT [I] 22/2002

DATA: 26.12.2002

Në bazë të rregullores së UNMIK-ut numër 19 /2001, të dates 4 tetor 2001, mbi degën e Ekzekutivit të organeve të përkohëshme të vetqeverisjes në Kosovë dhe nenit 6.1 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, numër 20/2002, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (më tutje MASHT) nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

NENI 1

QËLLIMI

1.1 Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave të nevojshme për studentët që përfitojnë asistencë në rastet e regjistrimit dhe shkollimit në Universitetin e Prishtinës.

NENI 2

KATEGORIA E STUDENTËVE QË DO TË PËRFITOJNË ASISTENCË PËR REGJISTRIM DHE SHKOLLIM

- a. Studentët, familjet e të cilve janë në asistencë sociale si dhe studentët familjet e të cilëve nuk kanë asnjë burim të të ardhurave
- b. Studentët- invalid të luftës
- c. Studentët që kanë mbetur pa prindër si pasojë e luftës së fundit;
- d. Studentët me aftësi të kufizuara fizike

NENI 3

Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale si dhe studentët, familjet e të cilve nuk kanë asnjë burim të të ardhurave

3.1.a studentët, familjet e të cilve janë në asistencë sociale konsiderohen ata studentë, familjet e të cilëve janë në evidencën e përfituesve të asistencës sociale

3.1.b Studentët, familjet e të cilëve nuk janë në asistencë sociale por nuk kanë asnjë burim të të ardhurave.

3.2.a Studentët për të përfituar statusin nga neni 3.1.a duhet të paraqes këto dokumente
- Vërtetimin nga Qendra për Punë Sociale, në të cilin vërtetohet se familja e studentit është shfrytëzues i ndihmave sociale.

3.2.b Studentët për të përfituar statusin nga neni 3.1.b duhet të paraqes këto dokumente
- Vërtetimi nga Enti për Punësim me të cilën vërtetohet se familja e tij nuk janë në mardhënie pune.

- Vërtetimin nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa pran Kuvendit Komunal me të cilin dëshmohet se nuk ngarkohen me tatim nga të ardhurat kadastrale, përkatësisht se nuk ushtrojnë veprimtari biznesi.

-Çertifikatën e lindjes apo letërnjoftimin e kopjuar të prindërve që vërtetohet që prindrit janë mbi moshën 65 vjeqare.

NENI 4

Studentët invalid të luftës

4.1 Studentët invalid të luftës konsiderohen ata student të cilët nga lufta e fundit kanë mbetur me aftësi të kufizuara fizike.

4.2 Studentët për të përfituar statusin nga neni 4.1 duhet të paraqes këto dokumente:

- Vërtetimin nga shoqata e invalidëve të luftës
- Çertifikatën e mjekut specialist.

NENI 5

Studentët të cilët kanë mbetur pa prindër si pasoj e luftës

5.1 Studentët të cilët kanë mbetur pa të paktin njërin nga prindërit si pasoj e luftës konsiderohen të gjith ata student që gjat luftës së fundit kanë humbur së paku njërin nga prindërit e tyre.

5.2 Studenti për të përfituar statusin nga neni 5.1 duhet të paraqes këto dokumente:

- Çertifikatën nga zyra e regjistrimit civil të Kuvendit Komunal si dëshmi për humbjen e prindit në luftë dhe vërtetimit se nuk ushtron veprimtari biznesi pjesa tjetër e familjes
- Çertifikatën e lindjes së aplikuesit (studentit)

NENI 6

Studentët me aftësi të kufizuara fizike

- 6.1 Studentët me aftësi të kufizuara fizike konsiderohen ata studentë, aftësit e të cilëve nuk mundësojnë punë fizike si pasojë e retardimeve të lindura apo dëmtimeve fizike si p.sh. (distrofët, hemiplegjikët, paraplegjikët etj).
- 6.2 Studenti për të përfituar statusin nga neni 6.1 duhet të paraqes këto dokumente
- Çertifikatën e mjekut specialist me të cilën dëshmohet aftësia e tij e kufizuar fizike

NENI 7

Përfitimet nga fondet e grumbulluara

- 7.1.a Bursën universitare përfitojnë studentët e dalluar, të cilët kanë notën mesatare 9 (nëntë)
- .b. Studentët të cilët kanë note mesatare mbi 9 dhe janë raste sociale mund të përfitojnë nga të dy aspektete (për regjistrim dhe burse)
 - .c. Bursa për shkollim jashtë vendit për kuadro deficitare për studentët e dalluar në rastet e veqanta
 - .d. Ndihma për shërim në rastet e sëmundjeve të rënda
 - .e. Aktivitetet e Unionit të pavarur të studentëve ose inicjativave tjera studentore që konkurojnë me program konkre .

NENI 8

- 8.1 Të gjithë studentët të cilët paraqesin conform kushteve të parapara në këtë Duhëzim Administrativ- dokumentet e nevojshme duhet të dorzojnë në fakultetin apo në shkollën e lartë përkatëse.
- 8.2 Vendimin për përfundimin e asistencës e nxjerr komisioni I përbër nga MASHT dhe Universiteti I Prishtinës.

NENI 9

Fuqizimi

- 9.1 Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me 26. 12. 2002

Isuf Zeneli
Sekretar I Përhershëm
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë